

Procedurat dhe mekanizmat për të bërë kërkesë dhe ankesë që lidhen me veprimet ose mosveprimet e AP (Përfshirë adresën postare/elektronike për depozitimin e kërkesave dhe ankesave- Afatet dhe mënyra e kthimit të përgjigjeve).

Në bazë të Ligjit Nr. 9718 datë 19.04.2007, Urdhri i Infermierit përcaktohet si Ent Publik jobuxhetor, cili përfaqëson interesat e përbashkët të profesioneve të infermierit/es, mamisë, fizioterapeftit/es, teknikut/es të/së laboratorit, teknikut/es të/së imazherisë dhe logopedistit/es, si dhe rregullon marrëdhëniet ndërmjet tyre, në funksion të publikut.

Urdhri i Infermierit përbëhet nga infermierët dhe mamitë fizioterapeft/e, teknik/e laboratorit, teknik/e imazherie dhe logopedist/e që kanë diplomën përkatëse dhe që e ushtrojnë profesionin në Republikën e Shqipërisë.

Anëtarë të Urdhrit të Infermierit bëhen edhe të gjithë infermierët dhe mamitë, fizioterapeft/e, teknik/e laboratorit, teknik/e imazherie dhe logopedist/e shtetas shqiptarë dhe të huaj, të diplomuar jashtë vendit, pas njohjes së diplomës, sipas legjislacionit në fuqi.

Shtetasi i huaj, që të ushtrojë profesionin e infermierit dhe mamisë fizioterapeft/e, teknik/e laboratorit, teknik/e imazherie dhe logopedist/e në Republikën e Shqipërisë, duhet të jetë anëtar relativ i të njëjtit urdhër në vendin e vet ose në vendin ku së fundi ka ushtruar këtë profesion.

Përfshihen nga ky detyrim, por jo nga e drejta e anëtarësimit në këtë organizëm, nëpunësit e administratës shtetërore, për sa kohë ata nuk ushtrojnë veprimtari të mirëfilltë si infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laboratorit, teknik/e imazherie dhe logopedist/e.

Ankesat kundër vendimeve për marrjen e masave disiplinore nga komisionet disiplinore, pranë këshillave rajonale të Urdhrit të Infermierit paraqiten në komisionin disiplinor të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Infermierit brenda 30 ditëve nga komunikimi me shkrim i vendimit.

Komisioni disiplinor i Këshillit Kombëtar, brenda 30 ditëve nga marrja e ankesës, detyrohet të japë vendimin për ankesën e paraqitur. Vendimi i komisionit disiplinor të Këshillit Kombëtar është përfundimtar.

Kundër vendimit të komisionit disiplinor të Këshillit Kombëtar, personi ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës brenda 30 ditëve nga data e komunikimit me shkrim të vendimit.

Ankesat mund të dërgohen nëpërmjet adresës elektronike uish_albania@yahoo.com, ose mund të dërgohen në rrugë postare në adresën: **Rruga “Reshit Petrela”, Tek Dispanceria Kati II-të, Tiranë.**